

Dega në Shqipëri e shoqërisë ELMAC II S.r.l
Degë e Shoqërisë së Huaj

Pasqyrat Financiare Individuale
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

TIRIANO TREDESE

Tiriano Trede

Emërtimi dhe Forma ligjore

Dega në Shqipëri e shoqërisë ELMAC II S.r.l
– Degë e Shoqërisë së Huaj

NUIS
Adresa e Selisë

L81630017A
Rr. Abdi Toptani, Ndërtesa Torre Drin, Kati 4, Ap. 10, Tiranë

Data e krijimit

30/04/2018

Veprimtaria Kryesore

Projektimin, prodhimin, ndryshimin, riparimin dhe shitjen e aparatave elektrike, elektromekanike dhe elektronike ne përgjithësi dhe pjesëve te këmbimit dhe aksesoret përkatës, montimin, shitjen dhe menaxhimin e videolojrave, juke-box, flipper, bilardo dhe aparatura te tjera argëtuese, etj.

PASQYRAT FINANCIARE

(Në zbatim të Standardit Kombëtar te Kontabilitetit Nr.15 dhe
Ligjit Nr. 9228 Datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”)

Viti 2019

Pasqyrat Financiare janë individuale	Po
Pasqyrat Financiare janë të konsoliduara	Jo
Pasqyrat Financiare janë të shprehura në	Lekë
Pasqyrat Financiare janë të rrumbullakosura në	-
Periudha Kontabël e Pasqyrave Financiare	Nga 01.01.2019 Deri 31.12.2019
Data e mbylljes së Pasqyrave Financiare	22.03.2020

Përmbajtja:

	Faqe
Bilanci më 31 dhjetor 2019	1
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	3
Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	4
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare	5 – 12



Dega në Shqipëri e shoqërisë ELMAC II S.r.l.

Bilanci

më 31 dhjetor 2019

(shumat në Lek)

<u>Aktivitet</u>	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
I. Aktivet afatshkurtra			
Mjete monetare	4	612,792	765,390
Aktive financiare afatshkurtra	5	1,980,574	1,909,580
Inventari	6	781,113	781,113
Total i aktiveve afatshkurtra (I)		3,374,479	3,456,083
II. Aktivet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	7	5,695,834	7,045,380
Aktivitet afatgjata jomateriale		-	-
Totali i aktiveve afatgjata (II)		5,695,834	7,045,380
Totali i aktiveve (I + II)		9,070,313	10,501,463
<u>Detyrimet dhe kapitali</u>			
I. Detyrimet afatshkurtra			
Detyrimet për t'u paguar dhe parapagimet	8	1,214,838	1,330,623
Detyrime të tjera afatshkurtra	9	253,151	222,156
Totali i detyrimeve afatshkurtra (I)		1,467,989	1,552,779
II. Detyrimet afatgjata			
Huatë afatgjata		-	-
Detyrime të tjera afatgjata	10	11,980,188	11,671,344
Totali i detyrimeve afatgjata (II)		11,980,188	11,671,344
Totali i detyrimeve (I + II)		13,448,177	13,224,123
III. Kapitali			
Kapitali i nënshkruar	1	-	-
Rezervat statutore dhe ligjore		-	-
Fitimet (humbjet) e akumuluar		(2,722,660)	-
Fitimi (humbja) e vitit		(1,655,204)	(2,722,660)
Totali i kapitalit (III)		(4,377,864)	(2,722,660)
Totali i detyrimeve dhe kapitalit (I,II,III)		9,070,313	10,501,463

Bilanci duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 – 12 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 u aprovuan nga drejtimi i shoqërisë dhe u nënshkruan me 22 mars 2020 si më poshtë:


 DEGA NE SHQIPERI
 E ELMAC II S.R.L
 PR. KBD TOPTANI
 Tiziano Tredese
 KORRE DRIN, TIRANE
 Administrator L81630017A

Dega në Shqipëri e shoqërisë ELMAC II S.r.l.

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(shumat në Lek)

Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Periudha e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhurat nga shitja	11	365,633
Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit		812,467
Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces		-
Materialet e konsumuara	6	781,113
Kosto e punës:	6	(781,113)
<i>Pagat e personelit</i>	12	-
<i>Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore</i>		(34,944)
Amortizimet dhe zhvlerësimet	7	(52,104)
Shpenzime të tjera	7	(1,356,397)
Totali i shpenzimeve	13	(760,490)
Fitimi (humbja) nga veprimtaria kryesore		(2,203,935)
		(1,838,302)
Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njësitë e kontrolluara		-
Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesëmarrjet		-
Të ardhurat dhe shpenzimet financiare		-
Të ardhura (shpenzime) financiare nga investime		-
financiare afatgjata, neto:		-
Të ardhura (shpenzime) nga interesat, neto	13	-
Të ardhura (shpenzime) nga kurset e këmbimit, neto	14	(210)
Të ardhura (shpenzime) të tjera financiare, neto		183,098
Totali i te ardhurave dhe shpenzimeve financiare, neto		279,880
Fitimi (humbja) para tatimit		183,098
Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin	15	(1,655,204)
Fitimi (humbja) e vitit		(2,722,660)
		(1,655,204)

Pasqyrat e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 – 12 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Dega në Shqipëri e shoqërisë ELMAC II S.r.l.

Pasqyra e ndryshimeve në kapital

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(shumat në Lek)

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 - 12 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

	Kapitali aksionar	Fitime (humbje) të akumuluar	Totali
Pozicioni më 30 prill 2018	-	-	-
Fitimi (humbja) e vitit	-	(2,722,660)	(2,722,660)
Shpërndarje të fitimit	-	-	-
Pozicioni më 31 dhjetor 2018	-	(2,722,660)	(2,722,660)
Fitimi (humbja) e vitit	-	(1,655,204)	(1,655,204)
Shpërndarje të fitimit	-	-	-
Pozicioni më 31 dhjetor 2019	-	(4,377,864)	(4,377,865)



Dega në Shqipëri e shoqërisë ELMAC II S.r.l.

Pasqyra e flukseve monetare

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(shumat në Lek)

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Periodha e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Flukse monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit:		
Fitimi (humbja) para tatim fitimit	(1,655,204)	(2,722,660)
<i>Rregullime për:</i>		
Shpenzimet financiare jomonetare	(180,129)	(276,608)
Amortizimin	1,356,397	789,345
Zhvlerësim i aktiveve afatgjata materiale	21,514	-
Shpenzime të llogaritura	-	-
Flukse monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit përpara ndryshimeve në kapitalin qarkullues	(457,422)	(2,209,923)
<i>Ndryshime në kapitalin qarkullues:</i>		
Rënia (rritja) në llogaritë e arkëtueshme	(70,994)	(1,909,580)
Rritje/zvogëlim në tepricën e inventarit	-	(781,113)
Rritja/(rënia) në detyrimet për t'u paguar dhe parapagimet	(64,004)	1,614,691
Tatimi thjeshtuar mbi fitimin i paguar	-	-
Të ardhurat nga interesi	-	-
Interesa të paguar	-	-
Flukse monetare neto nga/(për) veprimtaritë e shfrytëzimit	(592,420)	(3,285,925)
Flukse monetare nga veprimtaritë e investimit:		
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	(28,365)	(7,834,725)
Blerje e aktiveve afatgjata jomateriale	-	-
Flukse monetare neto nga veprimtaritë e investimit	(28,365)	(7,834,725)
Flukse monetare nga veprimtaritë e financimit:		
Financime nga shoqëria mëmë	471,330	11,899,588
Fluksi i mjeteve monetare nga aktiviteti financues	471,330	11,899,588
Rritja/(rënia) neto e mjeteve monetare dhe të tjera ekuivalenteve	(149,455)	778,938
Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente në fillim të periudhës	765,390	-
Efekti i luhatjeve të kurseve të këmbimit të mjeteve monetare	(3,142)	(13,548)
Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente në fund të periudhës	612,792	765,390

Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 – 12 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Dega në Shqipëri e shoqërisë ELMAC II S.r.l.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

1. Informacion i përgjithshëm

Dega në Shqipëri e shoqërisë ELMAC II S.r.l. (në vijim referuar si “Dega”) është një Degë e shoqërisë së huaj ELMAC II S.r.l. dhe më datë 30 prill 2018 është regjistruar në regjistrin tregtar mbajtur nga Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) me NUIS L81630017A.

Aktiviteti i Degës konsiston në projektimin, prodhimin, ndryshimin, riparimin dhe shitjen e aparaturave elektrike, elektromekanike dhe elektronike në përgjithësi dhe pjesëve të këmbimit dhe aksesoret përkatës, montimin, shitjen dhe menaxhimin e videolojrave, juke-box, flipper, bilardo dhe aparatura të tjera argëtuese, blerjen, marrjen me qira dhe menaxhimin e bareve, restoranteve, picerive dhe me gjerësisht me administrimin e ushqimeve dhe pijeve në çdo lloj forme, të gjitha veprimet tregtare, administrative, financiare, bankare, (duke përfshirë mbledhjen e kursimeve ndërmjet publikut në çdo lloj forme), me pasuri të luajtshme (me përfshirë natyrisht, aktivitetet e rregulluara nga Dekreti Legjislativ i datës 24 shkurt 1998 n. 58), me pasuri të paluajtshme dhe hipotekare të nevojshme ose të dobishme për ushtrimin e aktivitetit të shoqërisë, të kontraktoshipësit të hipotekës dhe të lere në garanci reale dhe/ose personale edhe për detyrimet e të tjerëve, me mundësinë ndër të tjera për të marre, jo me qellim për të vendosur dhe sidomos jo përballë publikut, pjesëmarrje dhe interesime në shoqëri të tjera që kanë objekt të ngjashëm ose të lidhur me të, dhe ndërmarrjet e pjesëmarrjeve të tilla, ku përfshihet një përgjegjësi të pakufizuar për detyrimet e ndërmarrja, duhet të jenë të autorizuara nga Asambleja e ortakeve në përputhje me nenin 2479 pika katër e Kodit Civil.

Dega është e regjistruar me Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë dhe përfaqësuesi ligjor i saj është Z. Tiziano Tredese.

Selia e Degës ndodhet në Njësia Bashkiake nr. 2, Rr. Abdi Toptani, Ndërtesa Torre Drin, Kati 4, Ap. 10, Tiranë ndërsa adresa dytësore e saj ku ushtrohet dhe aktiviteti i Degës ndodhet në Njësia Administrative Mbrostar, Qendra Tregtare VIVA, Grecalli, Mbrostar, Ferko, Fier.

Numri i të punësuarve të Degës më 31 dhjetor 2019 është 1 (31 dhjetor 2018: 4). Numri mesatar i të punësuarve gjatë vitit 2019 është 1.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave

2.1 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, të përmirësuara (SKK), më konkretisht Standardit nr. 15 “Mbi parimet e kontabilitetit dhe raportimit financiar nga mikronjësiti ekonomike”, të cilat janë të aplikueshme në mënyrë prospektive duke filluar nga 1 janar 2015.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Degës.

2.4 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të kompanisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar, si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke pasur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Dega.

3. Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare mbi bazën e parimit të vijmësisë.

Dega në Shqipëri e shoqërisë ELMAC II S.r.l.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit, ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
1 EUR	121.77	123.42

3.2 Instrumente financiare

Instrumentet financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna, dhe llogari të pagueshme.

Instrumentet financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentet e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentet financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Dega bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Degës mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur Dega transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Dega angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktore të Degës skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentët të saj përfshijnë depozita pa afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se Dega nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar në interesin efektiv.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

Dega në Shqipëri e shoqërisë ELMAC II S.r.l.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

3.3 Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

(ii) Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që Dega do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke përdorur metodën lineare të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material dhe duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit. Toka nuk amortizohet.

Metodat dhe përqindjet e amortizimit për secilën kategori aktivesh afatgjata për periudhën aktuale janë si më poshtë:

Përmirësim në qiramarrje	Mbi vlerën kontabël neto	5%
Mobilje dhe orendi	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Pajisje informatike	Mbi vlerën kontabël neto	25%
Të tjera pajisje	Mbi vlerën kontabël neto	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

3.4 Zhvlerësimi

(i) Aktivet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktiviteti.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar i disponueshëm për shitje i njohur më parë në kapital, transferohet në shpenzime.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Dega në Shqipëri e shoqërisë ELMAC II S.r.l.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

(ii) Aktivet jo-financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të Degës, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.5 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Dega ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3.6 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

3.7 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë periudhës.

4. Mjetet monetare

Mjetet monetare më 31 dhjetor 2019 dhe më 31 dhjetor 2018 janë përbërë si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Arka:		
Arka në Lek	75,300	183,250
	75,300	183,250
Llogari rrjedhëse:		
Në Lek	503,562	401,991
Në Euro	33,930	180,149
	537,492	582,140
TOTALI	612,792	765,390

5. Aktive financiare afatshkurtra

Aktivitetet financiare afatshkurtra më 31 dhjetor 2019 dhe më 31 dhjetor 2018 janë përbërë si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
TVSH e arkëtueshme	1,980,574	1,909,580
TOTALI	1,980,574	1,909,580

Dega në Shqipëri e shoqërisë ELMAC II S.r.l.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

6. Inventari

Inventari më 31 dhjetor 2019 dhe më 31 dhjetor 2018 konsiston në inventar të imët të lidhur me lojërat elektronike dhe lëvizjet gjatë periudhës paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Gjendja e inventarit të imët në fillim të periudhës	781,113	-
Blerje gjatë periudhës	-	781,113
Gjendja e inventarit të imët në fund të periudhës	781,113	781,113

7. Aktivet afatgjata materiale

Aktivët afatgjata materiale më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 përbëhen si më poshtë:

	Pajisje informatike	Mobilje dhe orendi	Të tjera pajisje	Përmirësim në qiramarrje	Totali
<u>Kosto</u>					
Më 30 prill 2018	-	-	-	-	-
Shtesa	67,035	34,936	7,359,254	373,500	7,834,725
Pakësime	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2018	67,035	34,936	7,359,254	373,500	7,834,725
Shtesa	28,365	-	-	-	28,365
Pakësime	(21,514)	-	-	-	(21,514)
Më 31 dhjetor 2019	73,886	34,936	7,359,254	373,500	7,841,576
<u>Amortizimi i akumuluar</u>					
Më 30 prill 2018	-	-	-	-	-
Amortizimi për vitin	9,009	4,076	774,704	1,556	789,345
Më 31 dhjetor 2018	9,009	4,076	774,704	1,556	789,345
Amortizimi për vitin	14,719	6,172	1,316,909	18,597	1,356,397
Më 31 dhjetor 2019	23,728	10,248	2,091,614	20,153	2,145,743
<u>Vlera e mbetur</u>					
Më 30 prill 2018	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2018	58,026	30,860	6,584,550	371,944	7,045,380
Më 31 dhjetor 2019	50,158	24,688	5,267,640	353,347	5,695,834

8. Detyrimet për t'u paguar dhe parapagimet

Detyrimet për t'u paguar dhe parapagimet 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Të pagueshme ndaj furnitorëve	1,180,517	1,210,294
Detyrime për paga	12,569	32,397
Detyrime për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	21,752	86,057
Të tjera tatime për t'u paguar	-	1,875
TOTALI	1,214,838	1,330,623

9. Detyrime të tjera afatshkurtra

Detyrimet e tjera afatshkurtra më 31 dhjetor 2019 dhe më 31 dhjetor 2018 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Paradhënie nga personeli	253,151	222,156
TOTALI	253,151	222,156

Dega në Shqipëri e shoqërisë ELMAC II S.r.l.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

10. Detyrime të tjera afatgjata

Detyrimet e tjera afatgjata më 31 dhjetor 2019 më 31 dhjetor 2018 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Financime nga shoqëria mëmë	11,980,188	11,671,344
TOTALI	11,980,188	11,671,344

11. Të ardhura nga shitja

Të ardhurat nga shitja për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2018 konsistojnë në të ardhura nga shitja e xhetonave për pjesëmarrje në lojëra argëtuese elektronike si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Periudha e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga shitja	365,633	812,467
TOTALI	365,633	812,467

12. Kosto e punës

Kostoja e punës për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2018 përbëhet si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Periudha e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Paga dhe shpërblime	34,944	598,388
Kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	52,104	128,572
TOTALI	87,048	726,960

13. Shpenzime të tjera

Shpenzimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2018 përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Periudha e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime qiraje dhe adresë selie	147,835	590,022
Mirëmbajtje dhe riparime	-	774,500
Shërbime noteriale	-	42,700
Shërbime ligjore	-	323,862
Shërbime kontabël dhe fiskale	541,658	488,858
Shpenzime të ndryshme	23,914	10,341
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	333	292
Shpenzime transporti	-	8,340
Shpenzime për shërbimet bankare	32,351	31,127
Taksa dhe tarifa vendore	14,000	23,450
Gjoha dhe dëmshpërblime	399	5,000
TOTALI	760,490	2,298,492

14. Shpenzime për interesa

Shpenzimet për interesa për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2018 përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Periudha e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime për interesa	-	210
TOTALI	-	210

Dega në Shqipëri e shoqërisë ELMAC II S.r.l.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

15. Të ardhura (shpenzime) nga kurset e këmbimit, neto

Të ardhurat (shpenzimet) nga kurset e këmbimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2018 përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Periudha e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Fitime të realizuara nga kursi i këmbimit	187,656	15,466
Fitime të porealizuara nga kursi i këmbimit	831	291,650
	188,487	307,116
Humbje të realizuara nga kursi i këmbimit	(651)	(12,194)
Humbje të porealizuara nga kursi i këmbimit	(4,738)	(15,042)
	(5,389)	(27,236)
TOTALI	183,098	279,880

16. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin

Dega është e regjistruar me organet tatimore shqiptare si biznes i vogël me xhiro nën 8 milion Lek dhe si e tillë është subjekt i Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin ("TTHF").

Bazuar në legjislacionin shqiptar, norma e TTHF për vitin 2019 është 5% mbi fitimin e tatueshëm nëse qarkullimi i subjektit është më i lartë se 5 milion lekë në vit dhe vlera e tatimit është zero nëse subjekti është me qarkullim vjetor më të vogël se 5 milion lek.

Bazuar në legjislacionin tatimor shqiptar, Dega nuk ka të drejtë të mbartë humbjet tatimore duke qenë se kjo e fundit është tatimpagues subjekt i TTHF. Dega nuk njihet aktivitet tatimor të shtyra, nëse ka, duke qenë se nuk ka siguri të mjaftueshme në realizimin e fitimeve në periudhën vijuese.

Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimore konsiderohen vetëdeklarime deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore janë objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

Shpenzimi i TTHF për vitin 2019 dhe për vitin 2018 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Fitimi/ (humbja) e periudhës para tatimit	(1,655,204)	(2,722,660)
<i>Zëra shpenzimesh të panjohura:</i>		
Shpenzime për aktivitetin	21,514	10,342
Gjoha dhe dëmshpërblime	399	5,000
Totali i shpenzimeve të panjohura	21,913	15,342
Fitimi/(humbja) i tatueshëm	(1,633,291)	(2,707,318)
<i>Norma e T.Th.F. (qarkullimi <5 mln Lek)</i>	<i>0%</i>	<i>0%</i>
Shpenzimi i T.TH.F.	-	-

17. Transaksione me palë të lidhura

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Të arkëtueshme nga palët e lidhura:		
Parapagime dhënë administratorit	-	-
Detyrime ndaj palëve të lidhura:		
Paradhënie nga administratori	253,151	222,156
Financime nga shoqëria mëmë	11,980,188	11,671,344

Dega në Shqipëri e shoqërisë ELMAC II S.r.l.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

18. Angazhime dhe pasiguri

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Dega mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Degës, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj.

19. Ngjarje të mëpasshme

Nuk ka asnjë ngjarje të mëpasshme pas datës së raportimit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

